



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Shëndetësisë/Ministarstvo Zdravstva/Ministry of Health

30 Prill 2020
Nr. Xx/2020

Bazuar në nenin 132 të Ligjit Nr. 05/L -031 - Për procedurën e përgjithshme administrative, nenin 38 të Ligjit 04/L-190- Për Produkte dhe Pajisje medicinale, nenin 17 të Udhëzimit Administrativ 02/2019 - Për rregullimin e çmimeve të produkteve dhe pajisjeve medicinale, Vendimin nr. protokollit 35/2019, datë 27.06.2019, me rastin e shqyrtimit të kërkesës me Nr. 9, të datës 27.03.2020, nga Kompania **BLU FARM SHPK**, me seli në Prishtinë, me adresë: Muhamet Cami, me person përgjegjës **Kristina Dodo**, të ushtruar kundrejt vendimit të komisionit për çmime të publikuar më 23 Mars në webfaqen e MSH, Komisioni për çmime, në takimin e mbajtur me datë 30.04.2020, nxjerr këtë:

VENDIM

Nuk aprovohet kërkesa për rishqyrtim të çmimeve e parashtruar nga Kompania **BLU FARM SHPK** me seli në **Prishtinë**, rruga Muhamet Cami.

Çmimet finale janë si vijon:

1. Bocacort-S, 250 mcg, pressurised inhalation suspension: €9.90
2. Rinosol, 250 mcg, pressurised inhalation solution: €3.63
3. Salment, 25 mcg, pressurised inhalation suspension: €6.24
4. Serbo, 100mcg, nasal spray suspension: €5.00

Arsyetimi

Ministria e Shëndetësisë, përkatësisht komisioni për çmime bazuar në dispozitat e Udhëzimit Administrativ 02/2019 për rregullimin e çmimeve të produkteve medicinale pas zhvillimit të procedurave të parapara me aplikacionet, dhe evalumin e tyre më datë 23 Mars 2020 ka publikuar vendimin për përcaktimin e çmimeve të produkteve medicinale të cilat posedojnë autorizim për marketing pranë AKPPM. Bazur në paragrafin 1 të nenit 17 kundër vendimit të komisionit pala ka të drejtë të parashtrijë kërkesë për rishqyrtim në komisionin për çmime në afat prej 8 ditësh nga dita e publikimit të vendimeve.

Kompania **BLU FARM** me seli në Prishtinë, rruga Muhamet Cami, bazuar në paragrafin 1 të nenit 17 të UA 02/2019, brenda afatit ka parashtruar kërkesën për rishqyrtim të çmimeve të produkteve medicinale si vijon

1. Bocacort-S, 250 mcg, pressurised inhalation suspension, për të cilin ka aplikuar për çmimin €17.30
2. Rinosol, 250 mcg, pressurised inhalation solution për të cilin ka aplikuar për çmimin €6.50
3. Salment, 25 mcg, pressurised inhalation suspension për të cilin ka aplikuar për çmimin €7.18
4. Serbo, 100mcg, nasal spray suspension për të cilin ka aplikuar për çmimin €8.20

Komisioni duke u bazuar në dispozitat e udhëzimit administrativ përkatësisht në paragrafin 2 të nenit 17 të UA 02/2019 ka përcaktuar si vijon:

Emri i produktit	INN	Forma farmaceutike	Fortesia	Madhesia e paketimit	Cmimi i deklaruar	Cmimi në € në vendet referente/origji nës	Çmim i final në Euro	Komenti nga komisioni
Bocacort-S	fluticasone	PRESSURISED INHALATION, SUSPENSION	250 mcg	1 PCS 120 Dose	17.30	Gr - 9.90	9.90	Në mungesë të çmimeve në shtetet primare dhe sekondare cmimi është vendosur sipas cmimit ne vendin e oerigjinës.
Rinosol	beclometasone	PRESSURISED INHALATION, SOLUTION	250 mcg	5 PCS 200 Dose	6.50	AI – 3.63	3.63	Për shkak se çmimi është vetëm në një vend referent atëherë për vendosjen e cmimit është marë për bazë vendi i origjinës.
Salment	salmeterol	PRESSURISED INHALATION, SUSPENSION	25 mcg	1 PCS 120 Dose	7.18	AI – 6.24	6.24	Për shkak se çmimi është vetëm në një vend referent atëherë për vendosjen e cmimit është marë për bazë vendi i origjinës.
Serbo	budesonide	NASAL SPRAY, SUSPENSION	100 mcg	1 PCS 200 Dose	8.20	AI – 5.00	5.00	Për shkak se çmimi është vetëm në një vend referent atëherë për vendosjen e cmimit është marë për bazë vendi i origjinës.

Nga sa u tha u vendos si në dispozit të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Pala ka të drejtë ankese 15 ditë kalendarike pas shpalljes së kësaj përgjigjeje në Bordin për Ankesa për çmime të produkteve medicinale në Ministrinë e Shëndetësisë.

Komisioni për çmime:

1. Naim Bardiqi MSH kryetar _____
2. Selvete Shuleta AKPPM anëtare _____
3. Etrit Tetova AKK anëtar _____
4. Amir Keka FSSH anëtar _____
5. Shkumbin Jusufi OFK anëtar _____
6. Dardan Nallbani MTI anëtar _____
7. Blerta Kika MF anëtare _____

Vendimi i dërgohet:

Palës,

Departamenti farmaceutik,

Arkivës.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Shëndetësisë/Ministarstvo Zdravstva/Ministry of Health

30 Prill 2020

Nr. Xx/2020

Bazuar në nenin 132 të Ligjit Nr. 05/L -031 - Për procedurën e përgjithshme administrative, nenin 38 të Ligjit 04/L-190- Për Produkte dhe Pajisje medicinale, nenin 17 të Udhëzimit Administrativ 02/2019 - Për rregullimin e çmimeve të produkteve dhe pajisjeve medicinale, Vendimin nr. protokollit 35/2019, datë 27.06.2019, me rastin e shqyrtimit të kërkesës me Nr. 10, të datës 31.03.2020, nga Kompania **Bosnalijek**, me seli në Prishtinë, me adresë: Bahri Fazliu, me person përgjegjës **Aferdita Dushi**, të ushtruar kundrejt vendimit të komisionit për çmime të publikuar më 23 Mars në webfaqen e MSH, Komisioni për çmime, në takimin e mbajtur me datë 30.04.2020, nxjerr këtë:

VENDIM

Aprovohet pjesërisht kërkesa për rishqyrtim të çmimeve e parashtruar nga Kompania **Bosnalijek** me seli në Prishtinë, rruga Bahri Fazliu.

Çmimet finale janë si vijon:

1. Duoclav (Amoxicillin and enzyme Inhibitor), Film coated Tablet (875mg, 125mg), 10 PCS: €2.56
2. Duoclav (Amoxicillin and enzyme Inhibitor), Film coated Tablet (500mg, 125mg), 15 PCS: €2.46
3. Tozar, Atorvastatin, Film coated Tablet 20mg, 30 PCS: €3.72
4. Clodil, Clopidogrel, Film coated Tablet 75mg, 30 PCS: €7.99
5. Lanibos, Dogoxin, Tablet 0.25mg, 10 PCS: €0.56
6. Funzol, Fluconazole, Capsule hard 150mg, 1 PCS: €1.66
7. Flusetin, Fluoxetin, Coated Tablet 20 mg, 20 PCS: €2.05